



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLICA KOSOVO	
KOMUNA E VUSHTRISË - OPSTINA VUSHTRRI	
01 Nr. / Br	114 / 17
Nr. i fq. / Br. st	- 18 -
Data: / Datum	27. 4. 2017
VUSHTRRI - VUČITRN	



REPUBLIKA E KOSOVËS

KUVENDI I KOMUNËS-VUSHTRRI

PROCESVERBAL
NGA MBLEDHJA E -III- (E TRET) E RREGULLT E KUVENDIT TË KOMUNËS SË
VUSHTRISË, MBAJTUR MË 30 MARS 2017

Mbledhja është mbajtur në sallën e Kuvendit Komunal, duke filluar në orën 10:10.

Në këtë mbledhje ishin të pranishëm anëtarët e Kuvendit të Komunës në Vushtri:

Adnan Klinaku, Agim Bregaj, Agron Përçuku, Ali Januzi, Arta Ismajli, Bahrije Pllana, Fakete Dushi, Gentiana Rama, Habib Mustafa, Hysni Gërguri, Ilmi Azemi, Isa Hajrizi, Mehmet Selaci, Mejreme Ismajli, Melihate Basholli, Mentor Ferizi, Mirjeta Salihu, Muharrem Shabani, Myrvete Hetemi, Qerim Selimi, Rrahim Ajeti, Sabri Ferati, Safet Idrizi, Safet Osmani, Selim Rustemi, Selvete Sholla, Syzana Sylja, Shaban Beka, Shkelzen Feka, Shpëtim Zhegrova, Tasim Gubetini, Xhevahire Selmani dhe Zoran Rakiç.

Munguan: Ergin Sunguri dhe Habibe Gërxhaliu.

Të pranishëm në këtë mbledhje ishin edhe kryetari i komunës, nënkryetari i komunës, përfaqësuesi i KFOR-it, përfaqësuesi i OSBE-së dhe përfaqësues të shoqërisë civile.

Mbledhjen e hapi dhe e kryesoi Shpëtim Zhegrova – kryesues i kuvendit, i cili vërtetoi se ka shumicë për punë dhe hapi debatin për rendin e ditës.

Shpëtim Zhegrova, kryesues i kuvendit – pasi hapi mbledhjen, ftoi anëtarën e re të kuvendit të komunës që ta jap betimin, e cila është zëvendësuar me vendim të KQZ-së.

Gentiana Rama, anëtare e kuvendit – dha betimin para kuvendit dhe në këtë rast u bë anëtare e kuvendit me të drejta të plota.

Shpëtim Zhegrova, kryesues i kuvendit – pasi prezantoi rendin e ditës, njoftoi anëtarët e kuvendit se përmes adresës elektronike nga Sekretaria e Kuvendit janë dërguar tri pika shtesë, të cilat i propozoi që të futen në rend të ditës për shqyrtim. Pastaj njoftoi anëtarët e kuvendit lidhur me përgjigjen në ankesë të bërë nga ana e MAPL-së e cila ka ardhur si rezultat i ankesës së ushtruar nga ana e një pjese të anëtarëve të kuvendit lidhur me PZHK-në, ku janë konstatuar shkelje ligjore sa i përket thirrjes së asaj mbledhjeje. Lidhur me mosfrimin e procesverbalit nga mbledhja e jashtëzakonshme njoftoi se ky procesverbal nuk është hartuar sepse zyrtarët e sekretarisë bashkë me disa anëtarë të kuvendit kanë qenë në një udhëtim zyrtar në Suedi. Tutje shtoi se edhe përkundër paralajmërimeve të bëra nga ana e tij si kryesues i kuvendit, se mbledhja e jashtëzakonshme e datës 10 mars 2017 ishte në kundërshtim me ligjin, prapëseprapë anëtarin më i vjetër i kuvendit ka marrë mbi vete përgjegjësinë me vetëdije të plotë dhe ka ushtruar atë ditë detyrën e kryesuesit të mbledhjes dhe si pasojë e krejt këtyre dhe e shkeljeve tjera procedurale ka bërë që Ministria e Pushtetit Lokal të anulojë atë mbledhje të kuvendit. Mandej apostrofoi se ka pasur nguti dhe presione ndaj Sekretarisë së Kuvendit që të hartohet vendimi lidhur me Planin Zhvillimor Komunal dhe ky vendim është dërguar në ministrinë gjegjëse nga ana e sekretarisë së kuvendit, dhe tani pritet që ndaj këtij vendimi të ushtrojmë ankesë. Pastaj duke iu referuar anëtarit të kuvendit Mehmet Selaci, i cili kishte kërkuar përgjegjësi sa i përket mbajtjes së mbledhjes së kaluar dhe për këtë ai ceku se e vlerëson shumë lartë, andaj në këtë rast përsëriti se do të zmbrapej vetëm para Zotit dhe ligjit, duke bërë me

dije se është i gatshëm të japë përgjegjësi për të gjitha firmat e dhëna dhe për të gjitha veprimet e bëra si anëtar i kuvendit dhe si kryesues i kuvendit. Por gjithashtu duhet të përgjigjen të gjitha ata, të cilët me vetëdije të plotë dhe me njoftim vepruan në mënyrë kundërligjore në mbledhjen e kaluar, dhe apeloj që në këtë rast të merret edhe hetuesia dhe prokuroria e shtetit. Në fund tha se kur bëhet fjalë për mbledhjen e jashtëzakonshme të muajit janar kur dy anëtarë të kuvendit Qerim Selimi dhe Shaban Beka kishin lëshuar takimin në këtë rast ai nuk kishte konstatuar kuorumin dhe nuk kishte pretenduar se vendimi ishte aprovuar, por i kishte hapur rrugë që institucioni përgjegjës MAPL të merret me vlerësimin e ligjshmërisë së atij vendimi.

Ilmi Azemi, anëtar i kuvendit – në kuadër të diskutimit për rendin e ditës propozoi që të futet në shqyrtim kërkesa për ofrimin e ndihmës financiare për shërim e cila iu është drejtuar Drejtorisë së Shëndetësisë, por që në mungesë të mjeteve në këtë drejtori, kjo kërkesë nuk është përmbushur dhe proceduar me tutje. Kjo kërkesë ka të bëjë me Rona Zekën, vajza e Agim Zekës, e cila gjatë lindjes ka pasur komplikim dhe të njëjtës iu është rënduar gjendja shëndetësore.

Muharrem Shabani, anëtar i kuvendit – duke iu referuar deklarimeve të kryesuesit të kuvendit, vlerësoi se për temat të cilat janë kontestuese duhet pritur dhe marrë përgjigjen e autoriteteve përgjegjëse siç është Ministria e Pushtetit Lokal, dhe jo të lëshohemi në interpretime personale sepse në këtë rrafsh po shihet se sa është anshmëria dhe paanshmëria e dikujt tjetër. Prandaj e tërë kjo çështje i ka disa dimensione të veta duke u nisur nga mbledhja e përparme deri tek mbledhja e fundit. Tutje shtoi se në mbledhjen e fundit është luajtur me dinjitetin dhe autoritetin dhe është injoruar numri i njëzet anëtarëve të kuvendit. Pastaj duke iu referuar Udhëzimit Administrativ për Transparencë ceku se kryesuesi i kuvendit në bashkëpunim me Zyrën e kuvendit ka qenë i obliguar që nëpërmes Zyrës së informimit të bëjë informimin e anëtarëve të kuvendit dhe të publikut dhe kjo çështje nuk është bërë dhe për këtë duhet të japin përgjegjësi personat që kanë qenë të obliguar të përmbushin një gjë të tillë, si dhe duhet konstatuar se a ka pasur tendenca dhe prapavijë të caktuar nga ana e këtyre zyrtarëve, sepse ai kishte menduar se gjithçka ishte në suaza të ligjit kur kishte kryesuar takimin. Prandaj propozoi që kjo çështje të trajtohet nga çdo aspekt, sepse duhet bërë e ditur faktin se dikush qëndron prapa kësaj dhe dikush ka konflikt interesi në këtë çështje. Në këtë rrafsh ceku se kjo çështje duhet shikuar me analizë dhe me arsyeshmëri, dhe të gjithë personat dhe zyrtarët përgjegjës duke përfshirë edhe veten e tij të japin përgjegjësi për veprimet që janë të paligjshme. Pastaj kërkoi angazhimin e organeve kompetente komunale që në rrugën e fshatit Studime ku është vendosur semafori, në atë vend është i vendosur flamuri kombëtar, dhe ai flamur është vjetruar (është pluhurosur dhe shkatërruar deri në atë masë si nuk dallohet ngjyra e tij), dhe ky flamur duhet të hiqet nga aty, për faktin se në këtë formë vetëm sa po zhvlerësohet ky simbol kombëtar yni. Mandej duke marrë për bazë dukurinë mjaft shqetësuese të denoncimit të shtetësisë kosovare, kërkoi informatë me shkrim nga Drejtoria e Administratës lidhur me numrin e personave që kanë hequr dorë nga shtetësia në komunën tonë, e të cilët kanë shkuar në shtetet tjera. Gjithashtu kërkoi informatë me shkrim nga Drejtoria e Shërbimeve Publike, për rrënimin e pullazit, respektivisht objektit të stacionit të autobusëve, ku kërkoi të dihet se kush e ka bërë këtë veprim dhe a janë organet në dijeni për këtë akt.

Qerim Selimi, anëtar i kuvendit – duke iu referuar shkresës së MAPL, ku është shpallur e paligjshme mbledhja e jashtëzakonshme e kuvendit, vlerësoi se këtë çështje e mbështet dhe ceku se vendimet të cilat i merr kuvendi i merr jo për anëtarët e tij, por për qytetarët tanë. Tutje shtoi se tani nuk duhet të merremi me atë se çfarë ka ndodhur, por duhet të angazhohemi të gjithë që ai plan të aprovohet sa më parë dhe me konsensus të përgjithshëm në mënyrë që të hapet rruga e zhvillimit të gjithmbarshëm të komunës. Pastaj ceku se çështja e aprovimit të këtij plani është stërzgatur dhe nuk kemi nevojë që dikush të sakrifkohet për hir të kësaj çështjeje duke i marr për bazë interesat qoftë të individëve po grupeve të caktuara. Në fund kërkoi nga kryesuesi i kuvendit dhe shefat e grupeve kuvendare që sa më shpejt të “ulen” dhe të gjejnë një

zgjidhje lidhur me këtë plan që ai të aprovohet dhe të hapet rruga për zhvillimin e komunës sonë.

Shpëtim Zhegrova, kryesues i kuvendit – tha se shkresa që ka ardhur nga MAPL e kemi proceduar në kuvend që të njoftohen të gjithë dhe shtoi se lidhur me publikimin e njoftimit për mbledhje të jashtëzakonshme sekretaria e kuvendit e kishte njoftuar Zyrën për informim, dhe vlerësoi se është e njerëzishme që të ndodhin gabime, andaj njoftoi se në bisedë me zyrtarin e informimit ishte konstatuar se emilin e njoftimit të cilin e ka dërguar sekretaria e kuvendit kishte shkuar në opsionin junk email dhe zyrtari përgjegjës për informime nuk e kishte parë dhe hapur këtë email. Në fund apeloj dhe kërkoi nga të gjitha subjektet politike bashkërisht me kryetarin e komunës të gjejnë një konsensus dhe të aprovohet Plani Zhvillimor Komunal.

Në përfundim të diskutimeve rreth rendit të ditës, Kuvendi me vota 26 “për” të tjerat “abstenim” aprovoi këtë:

RENDITE

1. Shqyrtimi dhe aprovimi i ekstraktit nga mbledhja e jashtëzakonshme e kuvendit e datës 12.01.2017;
2. Shqyrtimi dhe aprovimi i procesverbalit nga mbledhja e rregullt e kuvendit e datës 23.02.2017;
3. Shqyrtimi i draft-planit për punësimin e personave me nevoja të veçanta;
4. Shqyrtimi i Raportit për situatën ekonomiko- financiare dhe zbatimin e planeve investuese për vitin 2016;
5. Shqyrtimi i Propozim-vendimit për bartjen e mjeteve financiare nga viti 2016 në vitin 2017;
6. Shqyrtimi i Propozim-vendimit për rialokimin e mjeteve financiare nga nënkategoria “subvencione për entitete publike” në nënkategorinë “subvencione për entitete jopublike” të Komunës së Vushtrrisë;
7. Shqyrtimi i Propozim-vendimit për ofrimin e ndihmës financiare për shërim për Pajtim Jasharin;
8. Shqyrtimi i Propozim-vendimit për rialokimin e mjeteve financiare brenda kategorisë së kapitaleve;
9. Shqyrtimi i Propozim-vendimit për rrënimin e pjesshëm të objektit të Shtëpisë së Kulturës “Hasan Prishtina”;
10. Shqyrtimi i Informatës rreth procedurës së legalizimit të objekteve;
11. Shqyrtimi i Informatës lidhur me rezultatet (ecurinë) e dhënies në shfrytëzim të tokave bujqësore;
12. Shqyrtimi i Informatës nga Zyra ligjore lidhur me zbatimin e marrëveshjes kolektive;
13. Shqyrtimi i Propozim-vendimit për shpërndarjen e mjeteve nga fondi për subvencione dhe transfere;
14. Shqyrtimi i Propozim-vendimit për dhënie në shfrytëzim afatgjatë të pronës së paluajtshme komunale;
15. Shqyrtimi i Raportit për punën e Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi;
16. Të ndryshme.
 - a). Shqyrtimi i Draft-Rregullores për plotësimin dhe ndryshimin e Rregullores për Transportin me Auto-merimangë,
 - b). Shqyrtimi i Propozim-vendimit për shpalljen e ankandit publik për shitjen e materialit ndërtimor të objektit të Komunës së Vushtrrisë,
 - c). Shqyrtimi i Propozim-vendimit për autorizimin e udhëheqësit të Zyrës ligjore për lidhjen e pajtimit gjyqësor,
 - ç). Shqyrtimi i Propozim-vendimit për ofrimin e ndihmës financiare për Rona Zekën.

1.Shqyrtimi dhe aprovimi i ekstraktit nga mbledhja e jashtëzakonshme e kuvendit e datës 12.01.2017.

Muharrem Shabani, anëtar i kuvendit – tha se në mbledhjen e kaluar me shumicën e votave të anëtarëve prezent u votua kundër këtij procesverbalit, për faktin se nuk kishte shprehje të realitetit në atë që ka ndodhur në atë mbledhje, në atë që është diskutuar dhe në atë që është vendosur. Prandaj përsëri në procesverbal thuhet se mbledhja është ndërprerë, gjë kjo që sipas tij nuk është e saktë, por mbledhja është vazhduar, është mbajtur, si dhe është përfunduar, por në mungesë të kuorumit dhe kjo në forma të ndryshme është konstatuar edhe nga MAPL-ja. Në fund tha se në këtë mbledhje është marrë një vendim në mënyrë ta paligjshme gjë kjo e cila është vlerësuar nga Ministria e Pushtetit Lokal.

Pas shqyrtimit të kësaj pike të rendit të ditës, Kuvendi pas votimit me 18 vota “për” 6 vota “kundër” të tjera “abstenim” aprovoi ekstraktin nga mbledhja e jashtëzakonshme e kuvendit e datës 12.01.2017.

2.Shqyrtimi dhe aprovimi i procesverbalit nga mbledhja e rregullt e kuvendit e datës 23.02.2017

Pas shqyrtimit të kësaj pike të rendit të ditës, Kuvendi pas votimit me 20 vota “për” të tjerat “abstenim” aprovoi procesverbalin nga mbledhja e rregullt e kuvendit e datës 23.02.2017.

3.Shqyrtimi i draft-planit për punësimin e personave me nevoja të veçanta

Lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, Kuvendi pas votimit me 21 “për” të tjerat “abstenim” vendosi me sa vijon:

1.Jepet në diskutim publik Draft-Plani i Veprimit për Punësim të Personave me Aftësi të Kufizuara të Komunës së Vushtrrisë 2017-2019.

2.Diskutimi publik fillon nga data 05 prill 2017 dhe zgjat deri më 20 prill 2017.

3.Obligohet Zyra komunale për informim që të ndërmer masa për informim të qytetarëve lidhur me diskutimin publik, konform dispozitave të Udhëzimit Administrativ për Transparencë në Komuna dhe konform nenit 9.2 dhe 9.4 të Rregullores për Transparencë 01 Nr.99/13, dt. 25.04.2013.

4.Obligohet Shoqata e fëmijëve dhe të rriturve me aftësi të kufizuara në Vushtri (HANDIKOS) që si hartues dhe propozues i Draft-Planit në fjalë, të organizojë diskutim publik konform Udhëzimit Administrativ (MAPL) Nr. 01/2015 për Transparencë në Komuna dhe nenit 9.5 të Rregullores për Transparencë 01 Nr.99/13, dt. 25.04.2013. Gjithashtu “HANDIKOS” obligohet që vërejtjet eventuale, sugjerimet apo propozimet për ndryshime t’ia prezantojë Kuvendit të Komunës në rastin e shqyrtimit të dytë të Draft-Planit në fjalë në mbledhjen e KK-së në muajin prill 2017.

4.Shqyrtimi i Raportit për situatën ekonomiko - financiare dhe zbatimin e planeve investuese për vitin 2016

Ilmi Azemi, anëtar i kuvendit – tha se kur bëhet fjalë për këtë raport, dhe për formën se si i ka trajtuar gjërat, duhet të vihen në pah të metat që i ka ky raport si p.sh tek faqja 6 e tij, në kategorinë buxhet me numër rendor 3, qiraja beson se ka gabim në raportim sepse kjo kategori

nuk ka të paraqitur asnjë “cent” si të planifikuara dhe asnjë “cent” të realizuar as për vitin 2015 dhe as për vitin 2016, në të njëjtën faqe në kategorinë gjeodezi, kadastër dhe pronë. Tek raporti i hipotekave për vitin 2016 janë paraqitur vetëm 350 € si të hyra dhe këtu sigurisht se bëhet fjalë për ndonjë gabim sepse ky inkasim bëhet vetëm në rastin e akordimit të një kredie. Pastaj tek listat poseduese dhe kopja e planit në të njëjtën kategori ekonomike planifikimi dhe realizimi për vitin 2015 dhe 2016 nuk është paraqitur fare dhe raportimi është zero, e që në fakt në këtë kategori kemi bukur shumë të hyra. Mandej në faqen 7 në kategorinë kulturë, rini dhe sport nga të hyrat e planifikuara për vitin 2016 gjithsej janë aprovuar si të hyra 15,000.00 € dhe janë realizuar 1,929.00 €, ose totali në këtë drejtori prej 17,100.00 € sa kanë qenë të planifikuara janë realizuar 3,202.00 € e që nënkupton se këtu kemi një performancë jashtëzakonisht të dobët. Andaj pyeti qeverinë, se a ka menduar ndonjë alternativë tjetër në mënyrë që të ngritet kjo performancë dhe të krijohen më shumë të hyra komunale për faktin se kjo është shumë e domosdoshme. Nga të cekurat më lartë dhe pa dashur të lëshohet edhe në detaje tjera, mund të vijmë në përfundim se ky raport për situatën ekonomiko- financiare është pjesërisht jo i plotë dhe si i tillë nuk është ai raport që e dëshirojmë dhe në të njëjtën kohë nuk mund të jepen as vërejtje dhe as lëvdata pasi që ky raport nuk plotëson kriterin e raportimit. Kështu që përveç tjerash të njëjtit i mungojnë të dhënat mbi obligimet e komunës për kontestet civile (paditë e ndryshme gjyqësore), andaj në këtë kontekst ceku se në këtë segment do të ishte mirë që këtij raporti t’i bashkëngjitet një deklaratë nga qeveria komunale ku do jepej garancioni se me këto konteste nuk do të rrezikohet buxheti i komunës.

Mejreme Ismajli, anëtare e kuvendit – në kuadër të diskutimit për shëndetësinë, ceku se një numër prej dhjetë punëtorëve shëndetësorë që janë pensionuar dhe mjetet nga kjo kategori propozoi që të shfrytëzohen për stimulimin e punëtorëve shëndetësorë në fshatra sikur në gjitha qendrat tjera, në kuadër të avancimit të vazhdueshëm profesional, doktori ose infermieri që ligjëron ai duhet të paguhet. Pastaj punëtorët që punojnë ditëve të festave duhet të paguhen dhe jo që kompensimi të jetë me nga dy ditë pushim për faktin se kjo nuk është zgjidhje e duhur për faktin se në këtë formë kemi mungesë të stafit shëndetësor në punë.

Muharrem Shabani, anëtar i kuvendit – tha se me qëllim të pasqyrimin real të gjendjes ekonomiko-financiare të komunës për vitin 2016 ceku disa sugjerime, duke shtuar se materialin lidhur me raportimin financiar, qoftë në aspektin periodik apo atë vjetor që një kohë të caktuar nuk e kemi votuar fare në kuvend edhe pse kjo është çështje është obligim ligjor. Pastaj shtoi se duhet të ketë transparencë të plotë sa i përket borxheve të painkasuara dhe këtë duhet ditur çdo anëtar i kuvendit, si dhe duhet bërë i ditur plani i komunës për inkasimin e këtyre borxheve. Duhet të njoftohemi për planin e komunës, për spastrimin dhe rregullimin e pronave të komunës, e që ka të bëjë me lirin e këtyre pronave nga uzurpatorët e paligjshëm. Nga raporti del fakti se gjatë vitit të kaluar nuk kemi asnjë procedurë të iniciuar për lirin e këtyre pronave, dhe kjo tregon për një papërgjegjësi të plotë nga ana e organeve komunale sa i përket menaxhimit të pronave komunale në komunën tonë. Tutje shtoi se e ka vlerësuar punën e Zyrës së informimit por tash del në pah fakti se “manipulohet me këtë zyrë” në mënyrën më të vrazhdë, sikurse është rasti i fundit. Një element tjetër që është shumë me peshë është çështja e kualitetit dhe afateve të punëve dhe projekteve kapitale në komunën tonë. Në raport nuk janë paraqitur të dhëna për këto çështje sikur është puna se sa operatorë ekonomik i kanë kryer punët brenda afateve kontraktuese, si dhe nuk raportohet për cilësinë e këtyre projekteve, por vetëm kemi përshkrime të përgjithësuara për këtë punë. Nuk ka përfundime të raportuara se çka e karakterizon gjendjen ekonomiko-financiare të komunës për vitin raportues. Mandej çështje tjetër mjaft relevante që nuk është trajtuar fare në raport është ajo e trajtimit të barabartë të komuniteteve dhe vendbanimeve duke u bazuar në parimin e vlerës së pagesës së tatimit në pronë nga ana e komuniteteve, andaj sa në të vërtetë është marrë për bazë kjo rregull për dhënien e prioriteteve për orientimin e investimeve infrastrukture në vendbanimet ku vlera e pagesës është e lartë. Në këtë kontekst është mjaft e nevojshme që të jepen të dhëna për numrin e tenderëve, numrin e pronave të dhëna me qira, nëse kemi atëherë këtu të hyrat figurojnë zero.

Andaj përveç pasqyrimin të gjendjes duhet të nxirren përfundime për ndërmarrjen e masave për ndryshimin dhe përmirësimin e gjendjes. Pastaj lidhur me rekomandimet e auditorit të përgjithshëm duhet të jepen statistika se sa ato janë adresuar dhe zbatuar nga ana e autoriteteve komunale.

Habib Mustafa, anëtar i kuvendit – tha se nuk është mirë që të tentohet të krijohet “imazh i keq” për Zyrën e informimit, pasi kjo zyre është shpallur ndër zyrat më të mira në nivel të Republikës së Kosovës, dhe tani pas një gabimi të bërë nuk është mirë të hidhet poshtë puna e tyre.

Safet Idrizi, anëtar i kuvendit – tha se në kuadër të këtij raporti, kishte me qenë mirë që të gjithë drejtorët e drejtorive komunale, të dalin dhe të raportojnë për punën e tyre, sepse është e pamundur që gjitha këto të përfshihen në raportin e kryetarit të komunës sepse ky raport është mjaft voluminoz. Kjo duhet bërë për faktin se çdo raport bëhet në bazë të planifikimit, dhe arsyeja e një raporti është që të shikohet performanca se sa është bërë realizimi i planifikimit. Pastaj vlerësoi se në raport janë përfshirë kategoritë e ndryshme siç janë: pagat dhe mëditjet, investimet komunale, mallrat dhe shërbimet, por duke e analizuar këtë raport nëpër secilin drejtori del se ky raport është mjaft sipërfaqësor dhe nuk paraqiten elementet thelbësore që duhet t'i ketë një raport. Mandej në çdo raport duhet të aplikohet metoda e krahasimit me vitin paraprak, dhe nëse ky raport paraqitet në mënyrë të qartë dhe transparente i njëjti na shërben për planifikim për vitin tjetër. Tek objektivat është dashur të paraqiten se sa objektiva janë realizuar, sa janë planifikuar dhe sa kanë mbetur të përealizuara, p.sh ngritja e cilësisë në mësim, ngritja e cilësisë së shërbimeve shëndetësore me intencë të zgjerimit të këtyre shërbimeve në vitet e ardhshme. Andaj në rastin e raporteve të drejtorive askund nuk flitet asnjë “fjalë” lidhur atë se ku kemi pasur ngritjen të cilësisë. Tek pagat dhe mëditjet realizimi ka qenë 96.99 %, dhe për këtë shprehu se në shëndetësi kemi një numër të konsiderueshëm të vendeve të punës që janë vakante, dhe këto vende nuk po mund të plotësohen edhe përkundër faktit se kemi mjaft individ që janë të diplomuar në lëmin e mjekësisë dhe kjo është mjaft shqetësuese. Në këtë relacion shtroi nevojën që të kemi një angazhim më të madh edhe të drejtorisë së linjës që të shikohet edhe në Ministrinë e Financave dhe të shihet se ku qëndron defekti, për faktin se është dëm i madh që ata persona që bëjnë një investim kaq të madh duke kryer fakultetin, si dhe duke u licencuar dhe mos të mund të gjejnë punë, edhe pse ka mjete dhe ka vende të lira pune. Tutje në faqen 6 të raportit ku thuhet planifikimi i të hyrave për periudhën janar-dhjetor 2016, ndërsa më lart shënon planifikimi mujor janar-dhjetor 2016, ku në administratë janë paraparë shuma prej 87,000.00€, për këtë pyeti se ky planifikim a është mujor apo vjetor. Mandej participimi i Drejtorinë së Shëndetësisë vlere 54,999.96, përqindja del 104.57 %, për këtë kërkoi sqarim sepse kjo përqindje duhet të jetë më e ulët. Pastaj pyeti Drejtorinë e Kadastrit, ku në faqen 5 të raportit janë dhënë shpenzimet sipas drejtorive, kategoria gjeodezi dhe kadastër, kodi ekonomik 650, realizimi i shpenzimeve 69 %, për këtë kërkoi sqarime se përse është kjo përqindje kaq e ulët dhe ku qëndron problemi për një realizim kaq të dobët. Shërbimet sociale rezidenciale realizimi 84 %, bujqësi, pylltari dhe zhvillim rural 91 %. Në faqen 5 përmbledhja e shpenzimeve sipas drejtorive, për këtë vlerësoi se në qoftë se drejtoritë nuk kanë pasur nevoja për shpenzimin e këtyre mjeteve, atëherë duhet të jemi të kujdesshëm që në të ardhmen mos të planifikojnë aq shumë mjete kur ato nuk po i shpenzojnë, por për këtë duhet të ketë një arsytim se përse nuk janë shpenzuar këto mjete. Sa i përket fushës së arsimit vlerësoi se është dashtë të kemi informacione për realizimin e vizitave sistematike dhe në kuadër të këtyre vizitave është vendosur që tek nxënësit që ka dyshime për sëmundje, kujdestarët e klasave do informojnë se ata nxënës a janë adresuar tek mjeku dhe a iu është përcaktuar gjendja shëndetësore, duke shtuar se kishte me qenë mirë që edhe anëtarët e kuvendit të njoftohen me punën lidhur me këto vizita sistematike. Në lëmin e shëndetësisë në raport thuhet se ka pasur ngritje të nivelit të cilësisë së shërbimeve shëndetësore si rezultat i ndërtimit të objekteve të reja shëndetësore dhe furnizimit me pajisje moderne shëndetësore. Mandej lidhur me vizitat sistematike, të cilat janë realizuar nëpër shkolla nga data 15 prill deri

me 15 maj 2016, përpunimi i të dhënave është përfunduar në muajin nëntor 2016, por në raport është shkruar se të dhënat janë në përpunim e sipër dhe këtë gjë drejtorja nuk e ka përfunduar me kohë. Tek pagat dhe mëditjet në Drejtorinë e Shëndetësisë kemi diku rreth dhjetë (10) vende vakante të punës në kohëzgjatje prej një viti dhe për këtë pyeti që çfarë ka ndodhur me ato paga nga ato vende të lira pune, mjetet a kanë shkuar në suficit apo janë ridestinuuar në tjera kategori, apo në ndonjë drejtori tjetër komunale që ka pasur shumë punëtorë dhe për këtë duhet dhënë sqarime. Në lëmin e ekonomisë, bujqësisë dhe pylltarisë, pyeti se sipërfaqja prej 25 hektarëve që janë pyllëzuar, duhet të dihet se ku janë bërë këtë pyllëzime në cilat vende, si dhe kërkoi që të dihet efekti praktik i dhënies së subvencioneve në kuptimin se a është rritur vetëpunësimi dhe a është përmirësuar gjendja sociale dhe a janë të efektshme.

Myrvete Hetemi, anëtare e kuvendit - duke iu referuar faqes 11 të raportit, ku ceket asfaltimi i rrugës në lagjen "Seladin Hyseni" në fshatin Ashlan, në këtë rast përsëriti se nuk bëhet fjalë për lagje, por për rr."Halit e Seladin Hyseni" kjo kërkoi që të përmirësohet. Mandej në faqe 12 rrugët e rendit të IV, për këtë në raport është shkruar se këto projekte janë përfunduar në tërësi, por ne jemi ne dijeni se ka me qindra rrugë të rendit të IV që janë të papërfunduara, dhe kjo gjë duhet të evidentohet në raport se cilat rrugë janë realizuar dhe cilat kanë mbetur të papërfunduara. Po ashtu në faqe 12 paragrafi 19, "rregullimi i varrezave të dëshmorëve" këtu duhet të specifikohet se në cilat vendbanime është bërë rregullimi i këtyre varrezave, gjithashtu në faqe 12, paragrafi 22 "ndërtimi i urave" duhet të dihet se cilat ura janë ndërtuar. Në faqe 13, rregullimi i kullës së UÇK-së të ceket se në cilin vend ndodhet kjo kullë. Faqe 18, numri i punëkërkuësve pyeti a është rastësi apo janë shifra së kodi ku ceket se numri i punëkërkuësve prej 40-54 vjeç ku punëkërkues janë 49 femra dhe 49 meshkuj.

Isuf Jashari, drejtor i DBF-së – paraqiti sqarime profesionale në lëmin e financave, duke u përgjigjur në temat e ngritura nga anëtarët e kuvendit.

Shpëtim Zhegrova, kryesues i kuvendit – njoftoi anëtarët e kuvendit, por edhe anëtarin e re, por edhe anëtarin e dorëhequr se data 31 mars është afati i fundit për deklarimin e pasurisë në Agjencinë Kundër Korrupsionit.

Mentor Ferizi, anëtar i kuvendit - tha se kur po flasim me shifra, drejtorët e drejtorive, po arsyetohen shumë mirë dhe shtoi se një projekt i votuar në kuvend për meremetimin e një shkollë në vlerë prej 5.000 €, janë ndërruar dy dyer dhe janë shtruar 100 m² pllaka të qeramikës dhe ky projekt do të mund të kushtonte maksimumi 2.000 € dhe kjo tregon se kemi një keqpërdorim sa i përket mjeteve publike. Tutje shtoi se projektet e rrugëve që po shtrohen nuk janë duke u përfunduar ashtu si janë planifikuar në letër dhe sa i përket trashësisë së zhavorrit, këtu me vetëdije apo pa vetëdije po bëhen keqpërdorime me paranë publike. Për këtë vlerësoi se nuk kemi monitorim të mirëfilltë nga ana e komunës dhe kjo po i dëmton rëndë interesat e qytetarëve tanë. Për këto dhe çështje tjera kërkoi sqarime nga drejtorët kompetent.

Isa Hajrizi, anëtar i kuvendit – pyeti sa a janë zbatuar aktet komunale, përkatësisht vendimet e kuvendit, duke aluduar se vendimi për formimin e Komisionit për Emërimin e Rrugëve nuk është zbatuar për faktin se anëtarët e tij nuk janë kompensuar për punën që kanë bërë.

Safet Idrizi, anëtar i kuvendit - tha se pasi që kryetari i komunës ligjërisht raporton para kuvendit, atëherë drejtorët e drejtorive kanë një komoditet, por sikur do të raportojnë ata vet sigurisht se do ishin më të përgjegjshëm. Tutje shtoi se është e padrejtë që mjetet financiare, që kanë mbetur nga pagat në shëndetësi si rezultat i mosplotësimit të vendeve të punës të kalojnë në arsim, dhe kjo në të njëjtën kohë nuk e dimë se a është e ligjshme.

Bedri Dobra, drejtor i DGJKP-së - paraqiti sqarime para anëtarëve të kuvendit lidhur me inkasimin dhe shpenzimin e mjeteve të buxhetit në lëmin e gjeodezisë dhe kadastrit.

Abdullah Klinaku, drejtor i DSHPS - së-dha sqarime lidhur me çështjen e shëndetësisë, duke u përgjigjur në temat e shtruar nga anëtarët e kuvendit.

Fadil Muzaqi, drejtor i Drejtorisë së Prokurimit - paraqiti sqarime lidhur me procedurat e prokurimit, duke cekur se të gjitha ato mjete financiare që teprojnë në projektet e ndryshme ato barten në saje të rishikimit të buxhetit, i cili bëhet me vendim të kuvendit.

Abdullah Klinaku, drejtor i DSHPS - së-dha sqarime lidhur me konkursin e caktuar ku u shpreh se organet e hetuesisë janë marrë me këtë dhe gjithçka ka qenë në rregull dhe transparente.

Safet Idrizi, anëtar i kuvendit - tha se është mirë që Drejtoria e Shëndetësisë së bashku me Drejtorinë e Buxhetit në koordinim me Ministrinë e Financave të gjejnë mundësinë që të bëhet rekrutimi i punëtorëve në lëmin e shëndetësisë.

5. Shqyrtimi i Propozim-vendimit për bartjen e mjeteve financiare nga viti 2016 në vitin 2017

Muharrem Shabani, anëtar i kuvendit – tha se kuvendi dhe qeveria komunale ka për obligim që në rastin e orientimit të investimeve kapitale të marrë për bazë çështjen e kryerjes së obligimeve të pagesës së tatimit në pronë. Tutje shtroi si të nevojshme përmbushjen e një kërkesë të banorëve të fshatit Stanoc i Poshtëm për rregullimin e kanalizimit. Mandej shprehu keqardhjen e tij për Shoqatën e të Verbërve, ku iu janë limituar subvencionet me vendim të kuvendit, ku nga 3.000 € sa ka qenë vitin e kaluar për këtë vit iu janë ndarë vetëm 500 €. Andaj propozoi që të shqyrtohet mundësia që kësaj shoqate t'i rriten subvencionet.

Shpëtim Zhegrova, kryesues i kuvendi – tha se deri në mbledhjen e ardhshme të kuvendit le të shqyrtohet mundësia që të gjinden mjete financiare për rritjen e subvencionit për shoqatën e të verbërve dhe nëse ato mjete gjenden, atëherë muajin e ardhshëm le të vjen propozim-vendimi dhe kuvendi do ta votojë.

Në fund të diskutimit lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, Kuvendi pas votimit me 18 vota “për”, të tjerat “abstenim” vendosi me sa vijon:

1. Me këtë vendim lejohet bartja e mjeteve financiare të lira të pashfrytëzuara nga të hyrat vetanake nga viti 2016 në vitin 2017 sipas Ligjit për Buxhetin të Republikës së Kosovës për vitin 2017, konform tabelave 4.1 dhe 4.2 sipas pozicioneve si në vijim:

1.1 Paga dhe mëditja.....	9,831.51 €
1.2 Mallra dhe shërbime.....	70,635.20 €
1.3 Shpenzime komunale.....	11,460.37 €
1.4 Subvencione dhe transfere.....	3,000.00 €
1.5 Investime kapitale.....	424,614.37 €
Shuma totale e mjeteve të bartura është.....	519,541.37 €.

2. Pjesë përbërëse e këtij vendimi janë tabelat 4.1 dhe 4.2, sipas të cilave bëhet bartja e këtyre mjeteve financiare të cekura në pikën 1 të këtij vendimi.

3. Për zbatimin e këtij vendimi obligohet Drejtoria për Buxhet dhe Financa.

6. Shqyrtimi i Propozim-vendimit për rialokimin e mjeteve financiare nga nënkategoria “subvencione për entitete publike” në nënkategorinë “subvencione për entitete jopublike” të Komunës së Vushtrrisë

Në fund të diskutimit lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, Kuvendi pas votimit me 19 vota “për” të tjerat “abstenim” vendosi me sa vijon:

1. Me këtë vendim rialokohen mjetet nga nënkategoria “subvencione për entitete publike” me kodin ekonomik 21110 në nënkategorinë “subvencione për entitete jopublike” me kodin ekonomik 21200, brenda programit Administrata e Arsimit (me kod buxhetor 92120), në shumën prej njëzet e tre mijë (23,000.00) €.

2.Për zbatimin e këtij vendimi obligohen: Drejtoria për Buxhet dhe Financa dhe Drejtoria për Arsim.

3.Ky vendimi hyn në fuqi pesëmbëdhjetë (15) ditë pas regjistrimit në Zyrën e Protokollit të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal, si dhe pas publikimit në faqen zyrtare të Komunës së Vushtrrisë.

7.Shqyrtimi i Propozim-vendimit për ofrimin e ndihmës financiare për shërim të Pajtim Jasharin.

Abdullah Klinaku, drejtor i DSHPS-së - sqaroi se mjetet financiare nga fondi për shërim janë shpenzuar pothuajse në tërësi dhe apeloj që të gjenden mjete për përmbushjen e kësaj kërkesë.

Isuf Jashari, drejtor i DBF-së – dha sqarime sa i përket subvencioneve për vitin 2017 sidomos për subvencionet për rastet për shërim.

Në fund të diskutimit lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, Kuvendi pas votimit në mënyrë unanime vendosi me sa vijon:

1.Me këtë vendim lejohen mjete financiare nga buxheti i komunës-fondi për subvencione dhe transfere, për Pajtim Jasharin, me banim në fshatin Pestovë të Komunës së Vushtrrisë, në shumën prej 2000 € (dy mijë euro).

2. Mjetet financiare të cekura në pikën 1 të këtij vendimi ndahen nga kategoria subvencione dhe transfere, të bartura nga viti 2016 në Zyrën e Kryetarit, dhe të njëjtat dedikohen për qëllim të shërimit të tij.

3. Për zbatimin e këtij vendimi obligohen: Zyra e Kryetarit, Drejtoria për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale dhe Drejtoria për Buxhet dhe Financa.

8.Shqyrtimi i Propozim-vendimit për rialokimin e mjeteve financiare brenda kategorisë së kapitaleve

Lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, Kuvendi pas votimit me 18 vota “për” të tjerat “abstenim” vendosi me sa vijon:

1.Me këtë vendim rialokohen mjete brenda kategorisë së kapitaleve në kuadër të programit të njëjtë (kategorisë së njëjtë) nga një nënkategori në tjetrën nënkategori të shpenzimeve.

2. Rialokimet e përmendura në pikën 1 të këtij vendimi janë të paraqitura në tabelën në vijim:

Emri i projektit	Kodi i projektit	Fondi 10	Fondi 21	Nga nënkategorira	Në nënkategorinë
Rrënimi i objektit të komunës dhe rregullimi i oborrit	45117	30,000.00	10,000.00	31120	32120
Sinjalizimi horizontal dhe vertikal	41408	5,000.00	10,000.00	31610	31230
Ndërtimi i serrave	43903	25,000.00	5,000.00	32050	33200

Pemëtari (mjedra, qersh, lajthi, fruta etj.)	45221	30,000.00	20,000.00	32055	33200
Përkrahje bizneseve të reja dhe ekzistuese me pajisje	45267	35,000.00	5,000.00	32055	33200
Shpronësimi i tokave	90237	20,000.00	81,163.00	31230	32100
Hartimi i projekteve	43910	50,000.00	21,200.00	31690	31230
Inventar për shtëpinë e komunitetit	45296	5,000.00		31110	31620
Pajisje për zërim	45312	8,000.00	2,000.00	31123	31690
Teknologji informative	43889		10,000.00	31690	31610

2.1 Projekti - rrënim i objektit të komunës dhe rregullimi i oborrit - të rialokohen mjetet nga nënkategoria *ndërtesat administrative afariste* (31120) në nënkategorinë *parqet nacionale* (32120).

2.2 Projekti - sinjalizimi horizontal dhe vertikal - të rialokohen mjetet nga nënkategoria *pajisje të teknologjisë informative* (31610) në nënkategorinë *ndërtimi i rrugëve lokale* (31230).

2.3 Projekti - ndërtimi i serrave - të rialokohen mjetet nga nënkategoria *bashkëfinancim me IPA* (32050) në nënkategorinë *transfere kapitale për entitete jo publike* (33200).

2.4 Projekti - pemëtari (mjedra, qersh, lajthi, fruta etj.) - të rialokohen mjetet nga nënkategoria *implementimi reformues* (32055) në nënkategorinë *transfere kapitale* (33200)

2.5 Projekti - përkrahje bizneseve të reja dhe ekzistuese me pajisje - të rialokohen mjetet nga nënkategoria *implementimi reformues* (32055) në nënkategorinë *transfere kapitale* (33200).

2.6 Projekti - shpronësimi i tokave - të rialokohen mjetet nga nënkategoria *ndërtimi i rrugëve lokale* (31230) në nënkategorinë *toka* (32100).

2.7 Projekti - hartimi i projekteve - të rialokohen mjetet nga nënkategoria *pajisje tjera* (31690) në nënkategorinë *ndërtimi i rrugëve lokale* (31230).

2.8 Projekti - inventar për shtëpinë e komunitetit - të rialokohen mjetet nga nënkategoria *ndërtesa të banimit* (31110) në nënkategorinë *mobile* (31620).

2.9 Projekti - pajisje për zërim - të rialokohen mjetet nga nënkategoria *objekte kulturore* (31123) në nënkategorinë *pajisje tjera* (31690).

2.10 Projekti - teknologji informative - të rialokohen mjetet nga nënkategoria *pajisje tjera* (31690) në nënkategorinë *pajisje të teknologjisë informative* (31610).

3.Për zbatimin e këtij vendimi obligohet Drejtoria për Buxhet dhe Financa.

9.Shqyrtimi i Propozim-vendimit për rrënimin e pjesëshëm të objektit të Shtëpisë së Kulturës "Hasan Prishtina";

Shpëtim Zhegrova, kryesues i kuvendi – tha se në Komitetin për Politikë dhe Financa jemi pajtuar që kompania të bëjë prezantimin para anëtarëve të kuvendit se si do të duket objekti i Qendrës së Kulturës “Hasan Prishtina”.

Përfaqësuesja e Kompanisë “Arhiko ing”- bëri prezantimin e projektit për ndërtimin objektiv të ri të Qendrës së Kulturës “Hasan Prishtina”.

Nexhat Merovci, menaxher i projektit - paraqiti sqarime lidhur me ndërtimin e objektiv të ri të Qendrës së Kulturës “Hasan Prishtina”, duke parashtruar të dhëna se si do të duket ky objekt sa i përket strukturës së saj, si dhe dha përgjigje në pyetjet e anëtarëve të kuvendit.

Mehmet Selaci, anëtar i kuvendit – pyeti se a janë marrë për bazë vërejtjet dhe propozimet nga takimi me qytetarë, për faktin se këtu kjo çështje u vlerësua si “imtësi” por kjo çështje akoma nuk është përfunduar. Pastaj theksoi se cili do të jetë metrazhi i objektiv të ri krahasuar me atë të vjetrin. Konkretisht objekti i ri a do të jetë më i madh apo më i vogël se objekti i vjetër. Mandej ai vlerësoi se do të ishte gabim që salla e leximit të jetë afër sallës së muzikës dhe vallëzimit për faktin se do të krijohesh shumë zhurmë.

Melihate Basholli, anëtare e kuvendit - pyeti se objekti i ri i Qendrës së Kulturës “Hasan Prishtina” a do të ketë qasje adekuate për personat me nevoja të veçanta e sidomos për personat me shikim të dobësuar. Ajo ceku se ky institucion duhet të emërtohet Qendra e Kulturës “Hasan Prishtina” e jo shtëpia e kulturës.

Shpëtim Zhegrova, kryesues i kuvendit – tha se në këtë mbledhje është mirë të merret vendimi për rrënimin e objektiv të qendrës së kulturës, pasi janë ndarë mjetet edhe nga niveli qendror për ndërtimin e objektiv të ri, kurse në mbledhjen e ardhshme do të mund të diskutohej më gjerësisht për tema tjera sa i përket kësaj çështjeje.

Ali Januzi, anëtar i kuvendit –njoftoi se kishte marrë pjesë në debatin me qytetarë, lidhur me çështjen e rrënit të objektiv të Qendrës së Kulturës “Hasan Prishtina”, ku nga ai takim kishte pasur përshtypjen se ne kemi mjaft kuadër në lëmin e arkitekturës, ku në atë rast u prezantuan njerëz që kishin studiuar në Vjenë, e të cilët i dhanë propozimet e tyre në atë takim. Pastaj për këtë apostrofoi se këta njerëz tanë të përgatitur po kanë vështirësi që të kyçen në procesin e zhvillimit të proceseve tek ne, dhe apeloj që kjo të ndryshohet në të ardhmen. Tutje citoi njërin nga ata arkitekt i cili kishte deklaruar se : “me shtyllat që janë paraparë të vendosen në këtë objekt kjo më tepër po i ngajmë arkitekturës greke”, dhe kjo patjetër duhet të përmirësohet. Pastaj citoi se njëri nga ata arkitekt kishte deklaruar se hartimin e këtij projekti do ta bënte pa pagesë. Mandej ai vlerësoi se komuna duhet të ketë kujdes në përcjelljen e zhvillimit të projekteve për shkak se kemi kualitet të dobët të punëve si p.sh spitali i qytetit posa u rinovua dhe menjëherë filloi të dëmtohet.

Dibran Përçuku, nënkryetar i komunës – tha se lidhur me objektin e Qendrës së Kulturës “Hasan Prishtina” janë zhvilluar disa debate me qytetarë, por edhe qeveria komunale, ka diskutuar dhe ka ftuar ekspertë për analizimin e kësaj çështjeje. Tutje shtoi se nga analizat e bëra nga ekspertët është konstatuar se objekti aktual nuk ka qëndrueshmëri me përjashtim të sallës së filmit e cila është ndërtuar më vonë nga pjesa tjetër e objektiv ekzistues. Mandej njoftoi se kuvendi në saje të aprovimit të buxhetit komunal ka ndarë 200,000 € për ndërtimin e kësaj qendre dhe 250,000.00 € janë ndarë nga Qeveria e Kosovës. Këto mjete janë ndarë për këtë vit, për vitin e ardhshëm nga kuvendi janë ndarë 400.000 €, gjithsej janë 850,000 €, kurse pjesën tjetër është zotuar se do ta mbulojë Qeveria e Kosovës. Duke iu referuar debateve me qytetarë, njoftoi se të gjitha vërejtjet dhe sugjerimet janë inkorporuar në këtë dokument, por tani ky projekt ndodhet në fazën ideore.

Mehmet Selaci, anëtar i kuvendit – tha se sa i përket qëndrueshmërisë së objektiv të kësaj qendre, në raport thuhet se ky objekt është relativisht dhe strukturalisht i qëndrueshëm dhe më tej në raport thuhet se nëse vendoset për zhvendosjen e mureve, atëherë duhet të futen shtylla përforcuese në objekt. Mandej ceku se si grup kuvendar i LVV-së kishin qenë “për” rrënimin e pjesëshëm të këtij objektiv, por jo që të ndërtohet një objekt i stilit si është prezantuar. Tutje shtoi se nëse ndodh që gjatë rrënit të këtij objektiv të dëmtohet salla, atëherë si do të veprohet për

faktin se nuk ka mjete, a do të futemi në partneritet publiko-privat, dhe pyeti se përse nuk është bërë edhe një projekt tjetër alternativ nga grupi i arkitektëve vushtrrias. Në fund tha se kishte me qenë mirë që të shkohet me dy apo tri propozime dhe të merret ai i cili është më i miri, si dhe vlerësoi se kishte me qenë mirë që ky vendim të shtyhet deri sa të finalizohet çështja se si do të ndërtohet objekti i ri.

Ilmi Azemi, anëtar i kuvendit – duke iu referuar parafolësit të tij, ceku se në raport lidhur me objektin e Qendrës së Kulturës “Hasan Prishtinës” është thënë se objekti i sipërcekur ka qëndrueshmëri dhe i njëjti mund të rinovohet. Tutje shtoi se edhe në komitet, por edhe më herët është shtruar nevoja e që ky objekt të marrë një formë tjetër, për faktin se ka nevojë për hapësira të reja. Në këtë kontekst duke marrë për bazë edhe bashkëfinancimin e këtij projekti me Ministrinë e Kulturës, sot duhet të merret vendimi me qëllim që mos të rrezikohet zhvillimi i këtij projekti. Sa i përket rregullimit të brendshëm dhe dukjes së jashtme të këtij objekti, për këtë do të mund të diskutonim në mbledhjen e ardhshme, dhe do t'i prezantonim ndryshimet e nevojshme, ndërse sa i përket lejimit të rrënimin të pjesshëm të këtij objekti bëri thirrje që të votohet me qëllim të zhvillimit të projektit me bashkëfinancim.

Muharrem Shabani, anëtar i kuvendit – tha se parimisht të gjithë jemi për të bërë zgjidhje, të përhershme, zgjidhje afatgjate dhe në interes të përgjithshëm për qytetarët. Zgjidhje që nuk e zvogëlon sipërfaqen e objektit ekzistues, për faktin se në të ardhmen mendohet që do të kemi rritje të popullatës dhe nevoja për hapësira të reja shtohet. Mandej shtoi se parimisht nuk është kundër rrënimin të këtij objekti, por ceku se do të ishte mirë që i njëjti operator ekonomik që e merr ndërtimin e objektit të ri të bëjë edhe rrënimin e objektit ekzistues. Gjithashtu ceku se zvogëlimi i sipërfaqes prej 3000m² në 2000m² është shumë i dëmshëm dhe kjo nuk na shërben që të ndodh. Në fund tha se është e domosdoshme që të bëhen analiza të nevojshme nga grupet e ekspertëve sa i përket hapësirës së brendshme dhe dukjes së jashtme të objektit që do të ndërtohet dhe mos të zvogëlohet sipërfaqja nga objekti ekzistues.

Shpëtim Zhegrova, kryesues i kuvendit – tha se duhet të merret vendimi për rrënimin e pjesshëm të objektit ekzistues të qendrës në fjalë, me qëllim që mos të rrezikohet zhvillimi i projektit të bashkëfinancuar, kurse lidhur me metrazhin e këtij objekti nuk kemi sqarime të duhura për faktin se ndërtimi i objektit po bëhet pa sallë dhe kjo nënkupton që kemi më shumë metra katror që po ndërtojmë.

Melihate Basholli, anëtare e kuvendit – tha se në propozim-vendim, duhet të rregullohet emërtimi nga shtëpi e kulturës në qendër të kulturës dhe pyeti se a do të mund ta kemi për mbledhjen e ardhshme projektin e detajuar për ndërtimin e Qendrës së Kulturës “Hasan Prishtina”. Pastaj vlerësoi se qysh herët kishte mbrojtur idenë që kjo qendër të ndërtohet nga komuna dhe jo në aspekte tjera publiko-private apo forma tjera, kurse tani shtoi se ndihet mirë që ky projekt po jetësohet.

Shpëtim Zhegrova, kryesues i kuvendit – tha se kur bëhet fjalë për partneritetin publiko-privat është diskutuar edhe në të kaluarën, por asnjëherë kjo formë e investimit nuk është realizuar në komunën tonë. Tani kur kryetari i komunës ka sjell një vendim të tillë tani të gjithë jemi të vullnetit që ta aprovojmë.

Nexhat Merovci, zyrtar i DUMM-së-paraqiti sqarime profesionale sa i përket qasjes dhe inkorporimit të hapësirës së vjetër me objektin e ri, si dhe sqarime sa i përket temave të ngritura nga anëtarët e kuvendit.

Mehmet Selaci, anëtar i kuvendit – kërkoi që të bëhet specifikimi se cila pjesë do të rrënohet dhe cila do të mbetet dhe kjo të ceket me metër katror në propozim-vendim.

Mentor Ferizi, anëtar i kuvendit - tha se njëherë kishte me qenë mirë që të merret vendimi për ndërtimin e objektit të qendrës së kulturës e tani të bëhet rrënimi.

Shpëtim Zhegrova, kryesues i kuvendit – tha se nuk ka nevojë që të merret vendim për ndërtim të këtij objekti, për faktin se mjetet financiare janë ndarë, dhe tani pritet të zhvillohen procedurat e prokurimit, si dhe të lidhet kontrata për ndërtimin e këtij objekti ku i njëjti operator do të marrë obligimin për rrënimin e objektit të vjetër.

Isa Hajrizi, anëtar i kuvendit – tha se në të njëjtin vendim do të ishte mirë të futet rrënimi i pjesshëm i objektit të qendrës së kulturës dhe objekti i vjetër i komunës.

Në fund të diskutimit lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, Kuvendi pas votimit me 17 vota “për”, të tjerat “abstenim” vendosi me sa vijon:

1.Me këtë vendim lejohet rrënimi i pjesshëm i objektit të Qendrës së Kulturës “Hasan Prishtina”, i cili gjendet në parcelën kadastrale me nr. P-70202016-00124-0 në vendin e quajtur “Varosh Marshalla” e cila përfshin një sipërfaqe prej 3313 m².

2. Për zbatimin e këtij vendimi obligohen: Drejtoria për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit, Drejtoria për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë, si dhe për Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport.

10.Shqyrtimi i Informatës rreth procedurës së legalizimit të objekteve

11.Shqyrtimi i Informatës lidhur me rezultatet (ecurinë) e dhënies në shfrytëzim të tokave bujqësore

12.Shqyrtimi i Informatës nga Zyra ligjore lidhur me zbatimin e marrëveshjes kolektive;

Musaj Tërbunja drejtor i DA-së – paraqiti sqarime hyrëse lidhur me informatën në fjalë, duke shtuar se disa obligime nga kontrata kolektive në fushën e arsimit, komunës do t'i shkaktojë shumë probleme financiare në mungesë të fondeve dhe përgjegjësit kompetent do të dalin keq para zyrtarëve dhe mësimdhënësve.

Muharrem Shabani, anëtar i kuvendit – tha se kjo temë ka një peshë të veçantë, si për të drejtat e mësimdhënësve ashtu edhe për reperkusionet që do të ketë komuna në kuptimin financiar. Tutje shtoi se çështja është trajtuar si duhet nga Zyra ligjore ku janë dhënë edhe rekomandimet të cilat sot duhen të aprovohen dhe të njëjtat të adresohen në institucionet kompetente, kjo për faktin se institucionet qendrore (qeveria) janë nënshkruese të këtij dokumenti dhe ajo duhet të gjejë zgjidhje, duke ndarë mjetet për përmbushjen e obligimeve që burojnë nga ky dokument ose të bëhet prolongimi apo abrogimi i këtyre dispozitave të marrëveshjes kolektive.

Idriz Muzaqi, udhëheqës i Zyrës ligjore - njoftoi kuvendin se nga prokuroria e shtetit ka marr përgjigje se nuk ka bazë dhe element të mjaftueshëm për iniciimin e procedurës për mbrojtjen e ligjshmërisë dhe në të njëjtën kohë përgjigje ka marr edhe nga Zyra ligjore e kryeministrit dhe përgjigjja ka qenë që komuna duhet t'i përmbush obligimet që kanë dal nga marrëveshja kolektive.

Në përfundim të diskutimeve lidhur me këtë pikë të rendit të ditës kuvendi unanimisht vendosi me sa vijon:

Me Marrëveshjen e Përgjithshme Kolektive të Kosovës (MPKK) të nënshkruar nga Kryeministri i Republikës së Kosovës dhe e cila ka hyrë në fuqi më 1 janar 2015 deri më 31 dhjetor 2017, të gjithë punëmarrësve, në rastin e pensionimit iu garantohen tri paga bazë në emër të shpërblimit jubilar dhe tri paga përcjellëse në rastin e pensionimit.

Me Qarkoret Buxhetore për vitet 2015, 2016 dhe 2017, si dhe me Ligjet për Buxhetin, për vitet 2015, 2016 dhe 2017, Qeveria e Republikës së Kosovës dhe Kuvendi i Republikës së Kosovës nuk kanë lejuar mjete financiare në mënyrë që punëdhënësi-Komuna e Vushtrrisë t'i përmbush obligimet financiare që dalin nga MPKK-ja .

Për shkak të faktit që komuna nuk ka të drejtë dhe mundësi financiare për përmbushjen e obligimeve në fjalë, të gjithë punëmarrësit me qëllim të realizimit të të drejtave të tyre të garantuara me dispozitat e MPKK-së, me kërkesat e tyre i drejtohen gjykatës kompetente e cila i aprovon si të bazuara.

Realizimi i kërkesave në procedurë gjyqësore për tri vite kalendarike tejkalon shumë prej 200,000.00 € dhe kjo do të ketë pasoja të pariparueshme për Komunën e Vushtrrisë.

Andaj, Kuvendi i Komunës së Vushtrrisë në mbledhjen e mbajtur më 30 mars 2017 pas shqyrtimit të informatës lidhur me zbatimin e Marrëveshjes së Përgjithshme Kolektive të Kosovës ka kërkuar:

- Që Qeveria e Republikës së Kosovës si nënshkruese e Marrëveshjes së Përgjithshme Kolektive të Kosovës të ndajë mjete financiare për përmbushjen e obligimeve që burojnë nga ky dokument për vitet 2015-2017;
- Qeveria e Republikës së Kosovës t'ia njeh të drejtën komunës që të ridestinojë mjete buxhetore nga projektet përkatëse për përmbushjen e obligimeve që dalin nga MPKK-ja, dhe
- Në të kundërtën Qeveria e Republikës së Kosovës ta pezullojë përkohësisht MPKK-në deri në sigurimin e mjeteve financiare.

13. Shqyrtimi i Propozim-vendimit për shpërndarjen e mjeteve nga fondi për subvencione dhe transfere

Shpëtim Zhegrova, kryesues i kuvendit – propozoi që nga disa klube sportive të hiqen nga 100 € deri të arrihet vlera prej 500 €, dhe këto mjetet të ndahen për shoqatën “Drita jonë”.

Isa Hajrizi, anëtar i kuvendit – tha se që dy mbledhje radhazi i kemi kërkuar raportet financiare për shpenzimin e mjeteve nga klubet sportive dhe pikërisht për këtë propozoi që kjo pikë e rendit të ditës të shtyhet për mbledhjen e radhës.

Agron Përçuku, anëtar i kuvendit - në saje të këtij propozimi shihen se kemi emërtime të klubeve që nuk përkojnë me emërtimet zyrtare të lëshuara nga ministria gjegjëse. Për klubin “Kosova” nuk janë azhurnuar ndryshimet dhe këto janë bërë me qëllime të caktuara për të kamufluar në kuptimin e përfitimit të subvencioneve, për faktin se i njëjti klub “Kosova e Vushtrrisë F” i ka bërë ndryshimet e duhura. Mandej shtoi se ka edhe klube tjera p.sh në volejball që janë të renditur më lart dhe të cilave nuk iu kemi ndarë mjete fare dhe kjo tregon se ka pasur parregullsi në ndarjen e subvencioneve ndaj klubeve sportive. Pastaj tek klubet e basketbollit p.sh “KB-Kosova e Vushtrrisë F”, dhe “KB-Kosova e Vushtrrisë-Basket” këto janë dy klube, të cilat udhëhiqen nga të njëjtit persona, dhe nuk është e arsyeshme që janë ndarë mjete për të dyja klubet, për faktin se KB-“Vushtrria Basket” është kategori e të rinjve të cilët po i shfrytëzojnë edhe palestrat e sporteve të shkollave të mesme dhe nxënësve të cilët po stërviten në këto salla po iu kërkohen mjete (para) dhe në këto raste ka edhe keqpërdorime, por edhe përkundër këtyre këtij klubi i janë ndarë mjete nga komuna.

Melihate Basholli, anëtare e kuvendit – tha se nuk do të ishte ide e mirë që të hiqen mjetet nga klubet sportive e sidomos nga klubet e femrave dhe t'i jepen shoqatës “Drita jonë” edhe përkundër konsideratës dhe nevojës që ka kjo shoqatë, por këto mjete të gjenden në ndonjë pozicion tjetër.

Në fund të diskutimit lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, Kuvendi pas votimit me 9 vota "për" 10 vota "kundër" të tjerat "abstenim" nuk e aprovoi propozimin e kryesuesit të kuvendit që shoqatës "Drita jonë" t'i ndahen mjete financiare në vlerë prej 500 €, andaj si rezultat i kësaj dhe mospajtimeve tjera, propozim-vendimi për shpërndarjen e mjeteve nga fondi për subvencione dhe transfere, shtyhet për mbledhjen e radhës.

14. Shqyrtimi i Propozim-vendimit për dhënien në shfrytëzim afatgjatë të pronës së paluajshme komunale

Muharrem Shabani, anëtar i kuvendit – tha se çështja e këtij propozim-vendimi, meriton të definohet në kuptimin ligjor, sa i përket bashkëpronësisë së pronës së pronarëve për tokën që gjendet nën ndërtesë ku kjo çështje nuk është e rregulluar dhe e definuar në kuptimin ligjor. Në këtë kontekst ai vlerësoi se për këtë vlerësim e ka shtyrë opinionin e Zyrës ligjore dhe rekomandimet e dhëna, andaj në këtë rast propozoi që kjo çështje të shtyhet për mbledhjen e ardhshme dhe të merret mendimi profesional i Departamentit Ligjor i Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, me qëllim që mos të hyjmë në çështje, të cilat janë të paqarta, të padefinuara dhe të kemi pasoja për komunën.

Ali Januzi, anëtar i kuvendit - tha se ku jepen në shfrytëzim pronat e komunës, personat zyrtarët kompetent, duhet të japin shpjegime lidhur me pronën se ku gjendet prona, statusi i saj dhe çështje tjera, me qëllim që vendimet që merren të jenë të drejta dhe që ato vendime të mos kthehen prapa. Tutje shtoi se shpeshherë kemi votuar kësi lloj vendimesh pa e ditur se çfarë po votojmë, dhe po ta pyet një qytetar se çfarë ka votuar nuk do të jetë në dijeni të japë shpjegim se për cilën pronë ka votuar.

Dibran Përçuku, nënkryetar i komunës – njoftoi kuvendin se kjo pronë gjendet në rr. "Skënderbeu" tek shkolla e policisë, ku ndodhet një ndërtesë gati e shkatërruar në të cilën jetojnë pesë familje e të cilat kanë bërë kërkesë që kjo ndërtesë të rrenohet dhe në vend të saj të ndërtohet një ndërtesë e re.

Bedri Dobra, drejtor i DGJKP-së - paraqiti sqarime lidhur me propozim-vendimin në fjalë duke u përgjigjur në pyetjet e anëtarëve të kuvendit.

Idriz Muzaqi, udhëheqës i Zyrës ligjore - tha se Ligji për të Drejtën e Ndërtesave në Bashkëpronësi, ia njeht të drejtën e pronësisë pronarit të njësisë banesore në tokën nën ndërtesë, dhe në këtë kontekst kemi një situatë të paqartë dhe jo vetëm për këtë rast po edhe disa prona tjera në territorin e komunës. Andaj ideja që të kërkohet mendimi i ministrisë gjegjëse është më se e qëlluar.

Shpëtim Zhegrova, kryesues i kuvendit – tha se për aprovimin e këtij propozim-vendimi, nevojiten 18 vota, dhe njoftoi se afati deri kur mund të jepet një pronë në shfrytëzim afatgjatë është 15 maji, ky është njoftimi zyrtar i MAPL-së.

Safet Idrizi, anëtar i kuvendit - pyeti se prona që po jepet në shfrytëzim a është pronë komunale, dhe a është dokumentacioni i kompletuar që kjo pronë të jepet në shfrytëzim me qëllim që të marrim një vendim të ligjshëm dhe mos të kthehet prapa ky vendim.

Bedri Dobra, drejtor i DGJKP-së - njoftoi se prona që po jepet në shfrytëzim është pronë komunale, dhe të gjithë pronaret e njësisë banesore i kanë të privatizuara banesat dhe posedojnë të gjithë dokumentacionin.

Ilmi Azemi, anëtar i kuvendit – tha se kemi arsye të plota ligjore që ta votojmë këtë propozim-vendim paraprak për dhënien e pronës në shfrytëzim, për arsye se më parë njëri nga pronarët nuk e ka dëshmuar pronësinë mbi njësinë banesore për shkak të mungesës së dokumentacionit. Por tani ky dokumentacion është kompletuar dhe kjo çështje mund ta procedohet dhe e njëjta të aprovohet. Andaj këta pronarë ligjërisht kanë të drejt të hyjnë në marrëveshje me komunën dhe të marrin aq metra katrore sa kanë aktualisht në ndërtesën e vjetër, ndërsa komuna e ruan interesin e saj në pronën tjetër. Tutje njoftoi se me sa është i informuar, përfaqësuesit e Drejtorisë së Urbanizmit i kanë marrë aprovimet në ministrinë

gjegjëse dhe janë inkurajuar që të vazhdohet me këtë projekt sipas formave ligjore të parapara me ligj. Andaj në fund tha se nuk sheh kurrfarë arsye ligjore që ky vendim të merret dhe të fillohet me zhvillimin e procedurave tjera për realizimin e këtij projekti.

Qërim Selimi, anëtar i kuvendit - tha se kjo çështje është e paqartë, për faktin se edhe Zyra ligjore e ka dhënë opinionin se duhet rregulluar çështja e bashkëpronësisë dhe tani është mirë të pritet derisa të merret mendimi i ministrisë gjegjëse dhe pastaj të procedohet dhe të aprovohet ky propozim-vendim.

Mehmet Selaci, anëtar i kuvendit – tha se personi i cili është më i thirruri të flet dhe ta mbrojë ligjshmërinë është zyrtari ligjor dhe ai vetë u deklarua se duhet marr mendimin e ministrisë gjegjëse. Andaj propozoi që kjo çështje të dërgohet në ministri për ta marrë mendimin dhe më tutje të procedohet, por forma qysh është, grupi kuvendar i LVV-së nuk do të mund ta mbështesë.

Shkelzen Feka, anëtar i kuvendit – në emër të grupit kuvendar të LDK-së, kërkoi që kjo pikë e rendit të ditës të shtyhet për mbledhjen e ardhshme dhe për këtë të merret mendimi i ministrisë gjegjëse.

Në fund të diskutimit lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, Kuvendi pas votimit në mënyrë unanime vendosi që ta marrë mendimin lidhur me ligjshmërinë e Propozim-vendimit për dhënie në shfrytëzim afatgjatë të pronës së paluajtshme komunale në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal.

15. Shqyrtimi i Raportit për punën e Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi

Muharrem Shabani, anëtar i kuvendit – kërkoi nga organet komunale, por edhe nga autoritetet e sigurisë që të respektojnë shenjat e komunikacionet sidomos ato që kanë të bëjnë me peshat, për faktin se peshat e rënda janë duke i shkatërruar rrugët tona, për faktin se nuk kemi kontrole nga organet komunale por as nga ato të policisë. Andaj për hir të interesit të përgjithshëm qytetar bëri apel që organet kompetente ta kryejnë punën e tyre në zbatimin e kontrolleve adekuate ndaj këtyre peshave që qarkullojnë nëpër rrugët tona.

16. Të ndryshme

a). Shqyrtimi i Draft-Rregullores për plotësimin dhe ndryshimin e Rregullores për Transportin me Auto-merimangë

Lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, Kuvendi pas votimit me 15 vota “për” të tjerat abstenim aprovoi, Rregulloren për plotësimin dhe ndryshimin e Rregullores për Transportin me Auto-merimangë.

b). Shqyrtimi i Propozim-vendimit për shpalljen e ankandit publik për shitjen e materialit ndërtimor të objektit të Komunës së Vushtrisë

Ilmi Azemi, anëtar i kuvendit – propozoi që këtij propozim-vendimi t’i shtohen edhe dy pika dhe atë me sa vijon, konkretisht pas pikës 1 të vihet ky tekst: me këtë vendim lejohet shpallja e ankandit publik për shitjen e materialit ndërtimor të pjesës së objektit të Qendrës së Kulturës “Hasan Prishtina” në Vushtrri. Pastaj pika tjetër që duhet t’i shtohet këtij vendimi duhet të ketë këtë përmbajtje: autorizohet kryetari i komunës që në rast se dështon ankandi për mungesë të ofertave, të formojë një komision profesional dhe të bëjë shpërndarjen e materialit ndërtimor të rrënuar për nevojtarët sipas prioritetit, nga Qendra e Kulturës “Hasan Prishtina” dhe nga objekti i komunës që do të rrënohet.

Lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, Kuvendi pas votimit me 20 vota “për” të tjerat “abstenim” vendosi me sa vijon:

1.Me këtë vendim lejohet shpallja e ankandit publik për shitje të materialit ndërtimor të objektit të Komunës së Vushtrrisë.

2.Autorizohet Kryetari i komunës që të themelojë komisionin profesional për përcaktim të vlerës fillestare të materialit, ndërsa organi kompetent i komunës të zbatojë procedurat e shitjes përmes ankandit publik.

3. Për zbatimin e këtij vendimi obligohen: Kryetari i komunës, Drejtoria e Prokurimit.

c). Shqyrtimi i Propozim-vendimit për autorizimin e udhëheqësit të Zyrës ligjore për lidhjen e pajtimit gjyqësor

Lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, Kuvendi pas votimit me 21 vota “për” të tjerat “abstenim” vendosi me sa vijon:

1.Me këtë vendim përfaqësuesi i autorizuar i kundërpropozuesit – Komunës së Vushtrrisë z. Idriz Muzaqi, autorizohet që të arrijë pajtim gjyqësor me përfaqësuesin e autorizuar të propozuesit - avokates Kada Bunjaku lidhur me lëndën CN.nr. 8/17, që në emër të:

1.1 Kompensimit nga pjesa e parcelës kadastrale nr.1046, në sipërfaqe prej 5 m², çmimi për m² prej 170.00 €, gjithsej 850.00 €, ashtu siç e ka vlerësuar edhe Zyra për vlerësimin e pronës së paluajtshme në kuadër të Ministrisë së Financave;

1.2 Kompensimit për zhvendosjen e dyerve të oborrit në vlerë prej 266.00 € (të cilat nuk janë përfshirë fare në aktin e vlerësimit nga Zyra për vlerësimin e pronës së paluajtshme);

1.3 Komuna e Vushtrrisë – kundërpropozuesi merr për obligim që të bëjë zhvendosjen dhe rregullimin e pusëtës për nevoja të propozuesit, në rastin e rregullimit të infrastrukturës teknike në rrugën “Arsim Muzaqi”, dhe

1.4 Në emër të shpenzimeve të procedurës gjyqësore, shumën prej **520.00 €**, ku përfshihen:

1.4.1 Për taksë gjyqësore: 15 €;

1.4.2 Për pjesëmarrje në tri seanca gjyqësore: 405.00 €, dhe

1.4.3 Për ekspertizë: 100 €.

1.5. Totali i shumës e cila duhet t’i kompensohet propozuesit është: 1,636.00 €.

2. Obligohet Drejtoria për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë dhe Drejtoria për Buxhet dhe Financa që të bëjnë ekzekutimin e pajtimit gjyqësor.

3. Për zbatimin e këtij vendimi obligohen: Kryetari i komunës dhe Zyra ligjore.

ç). Shqyrtimi i Propozim-vendimit për ofrimin e ndihmës financiare për Rona Zekën.

Isa Hajrizi, anëtar i kuvendit – propozoi që për shërimin e Rona/Agim/Zekën të ndahen 1000€, këto mjete ndahen nga Zyra e Kryetarit dhe për zbatimin e këtij vendimi obligohet Drejtoria për Buxhet dhe Financa dhe Drejtoria e Shëndetësisë.

Lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, Kuvendi pas votimit në mënyrë “unanime” vendosi me sa vijon:

1.Me këtë vendim lejohen mjete financiare nga buxheti i komunës-fondi për subvencione dhe transfere, për Rona/Agim/Zekën, me banim në Vushtrri, rr. “Skënderbeu” në shumën prej 1000 € (një mijë euro).

2. Mjetet financiare të cekura në pikën 1 të këtij vendimi ndahen nga kategoria subvencione dhe transfere, të bartura nga viti 2016 në Zyrën e Kryetarit dhe të njëjtat dedikohen për qëllim të shërimit të saj.

3.Mjetet financiare të cekura si më lartë ndahen në emër të Agim Zekës (prindi i Rona Zekës), pasi që përfituesja e këtyre mjeteve është e moshës së mitur.

4. Për zbatimin e këtij vendimi obligohen: Zyra e Kryetarit, Drejtoria për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale dhe Drejtoria për Buxhet dhe Financa.

Shpëtim Zhegrova, kryesues i kuvendit – konstatoi se Ergyn Sunguri dhe Habibe Gërzhaliu ndodhen në vizitë zyrtare në Suedi, për këtë arsye mungojnë në mbledhjen e kuvendit.

d). Pyetjet e anëtarëve të kuvendit:

Muharrem Shabani, anëtar i kuvendit – duke iu referuar banorëve të fshatit Pasomë, të cilët kërkojnë që të formohet një komision për ta konstatuar gjendjen e fundit të qarjes së shtëpive në këtë lokalitet nga detonimet e shfrytëzimit të gurëve (zhavorrit) nga ana e një operatori ekonomik, për këtë çështje kërkoi që kuvendi duhet të deklarohet dhe të kërkojë nga ekzekutivi që ta formojë një komision për konstatimin e gjendjes në atë fshat.


Agron Përçuku, anëtar i kuvendit - parashtrroi një kërkesë të banorëve të rr. “Arsim Tahiri” në magjistrale përballë Kosova Pertolit ku ka ekzistuar një nënkalim në të cilin frekuentojnë nxënësit e fshatrave Sllatinë dhe Tërlllobuq. Ky nënkalim tani është shkatërruar nga infrastruktura e dobët, hedhja e materialeve ndërtimore dhe mbeturinave tjera, andaj këta banorë kërkojnë që ky problem të rregullohet ashtu që të bëhet ndriçimi dhe bëhet shtrimi me kubëza. Pastaj pyeti Drejtorinë e Inspektiveve se çka është duke ndodhur me tokat që gjenden nën sistemin e ujitjes, ku janë duke u ndërtuar ndërtime të egra në rrugën magjistrale Vushtrri-Prishtinë. Mandej në qytet në rr. “Tirana”, janë vendosur disa terrasa të disa lokaleve e të cilat janë në rrugë, andaj për këtë pyeti se Drejtoria e Inspektiveve a është dal në terren dhe a i ka ndërmarrë masat e duhura.

Mbledhja përfundoi në orën 15:05


Bastri Duraku



Procesmbajtës



Shpëtim Zhegrova



Kryesues i Kuvendit